

ANEKS 1

Mbi disa ndryshime dhe përmirësime në “Rregulloren mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut; kriteret e gërmimit, dokumentimit dhe arkivimit të të dhënave dhe materialeve arkeologjike; kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e liçensave të ushtrimit të profesionit të arkeologut nga individë dhe subjekte private”, si më poshtë:

1. Neni 10, llojet e liçencave dhe klasifikimi i tyre, të shtohet:

B1. Survey dhe sondazh arkeologjik nënujor

B2. Gërmim arkeologjik **nënujor**

2. Neni 11, pika 3, të shtohet togëfjalëshi:

Nuk është e vlefshme asnjë lloj liçence në fushën e arkeologjisë, dhënë nga institucione të huaja “e pakonfirmuar nga KKA”.

3. Neni 11, pas pikës 3, të shtohet pika 4:

Shtetasit e huaj trajtohen njësoj me shtetasit shqiptarë në procesin e pajisjes me liçencë për veprimtari arkeologjike.

4. Neni 13, Arsimi dhe eksperiencia: Për të përfutur liçensën A1, individit duhet të jetë i pajisur me:, në pikën e tretë të shtohet:

Eksperiencë si autor dhe/ose bashkëautor në të paktën 3 (tre) projekte arkeologjike brenda dhe/ose jashtë vendit e vërtetuar (kopje e projektit ose raportit përfundimtar të depozituar në institucionin që ka dhënë miratimin).

5. Neni 13, Arsimi dhe eksperiencia: Për të përfutur liçensën A2, individit duhet të jetë i pajisur me:, në pikën e tretë të shtohet togëfjalëshi:

Eksperiencë si autor dhe/ose bashkëautor në të paktën 3 (tre) projekte arkeologjike brenda dhe/ose jashtë vendit e vërtetuar (kopje e projektit ose raportit përfundimtar të depozituar në institucionin që ka dhënë miratimin).

6. Neni 13, Liçenca e tipit B, të shtohet:

B. Projektim e zbatim për veprimtari arkeologjike nënujore.

Tipi. Drejtues projekti

Arsimi dhe eksperiencia:

Për të përftuar liçensën B1(Arkeologji nënujore), individi duhet të jetë i pajisur me:

- Diplomë të shkollës së lartë në fushën histori- arkeologji ose diplomë universitare të huaj, e cila të jetë e njohur nga MASH e barazvlefshme me diplomën e sipërpërmendur.
- Diplomë shkolle pasuniversitare (master i nivelit të dytë) brenda dhe jashtë vendit, të njohur nga MASH, në arkeologji nënujore.
- Gradën e tretë të zhytësit, ose superiore, të mbrojtur me një nga didaktikat e njohura në të gjithë botën si SSI, CMAS, PADI ose të ngjashme.
- Personi që do të liçensohet duhet të demonstrojë që gjatë punës së tij nën ujë do të jetë gjithmonë i shoqëruar nga të paktën një zhytës me gradën e dytë, ose superiore, të didaktikave SSI, CMAS, PADI ose të ngjashme.
- Të ketë sigurimin për jetën në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytësve DAN EUROPE.
- Eksperiencë si autor dhe/ose bashkautor në të paktën tre projekte arkeologjike nënujore brenda dhe/ose jashtë vendit e vërtetuar (kopje e projektit ose raportit përfundimtar të depozituar në institucionin që ka dhënë miratimin).

7. Neni 13, Liçenca e tipit B, të shtohet:

Arsimi dhe eksperiencia:

Për të përftuar liçensën B2, individi duhet të jetë i pajisur me:

Arsimi dhe eksperiencia:

Për të përftuar liçensën B2, (Arkeologji nënujore)

- Diplomë të shkollës së lartë në fushën histori- arkeologji ose diplomë universitare të huaj, e cila të jetë e njohur nga MASH e barazvlefshme me diplomën e sipërpërmendur.

- Diplomë shkolle pasuniversitare (master i nivelit të dytë) brenda dhe jashtë vendit, të njohur nga MASH, në arkeologji nënujore.
- Gradën e tretë të zhytësit, ose superiore, të mbrojtur me një nga didaktikat e njohura në të gjithë botën si SSI, CMAS, PADI ose të ngjashme.
- Personi që do të liçensohet duhet të demonstrojë që gjatë punës së tij nën ujë do të jetë gjithmonë i shoqëruar nga të paktën një zhytës me gradën e dytë, ose superiore, të didaktikave SSI, CMAS, PADI ose të ngjashme.
- Të ketë sigurimin për jetën në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytësve DAN EUROPE.
- Eksperiencë si autor dhe/ose bashkautor në të paktën tre projekte arkeologjike nënujore brenda dhe/ose jashtë vendit e vërtetuar (kopje e projektit ose raportit përfundimtar të depozituar në institucionin që ka dhënë miratimin).
- Grada Doktor në fushën e arkeologjisë dhe nëndegët e saj brenda ose jashtë vendit, e njohur nga MASH.

8. Neni 13, pas paragrafit që përcakton dokumentacionin e nevojshëm për t'u pajisur me Liçencë të tipit B2 (arkeologji nënujore), të shtohen specifikimet e mëposhtme:

Kërkuesi i liçencës duhet të vërtetojë se në momentin e aplikimit është procesin e ndjekjes së programit të doktoraturës.

Nëse brenda një afati kohor prej 3 (tre) vjetësh pas marrjes së liçencës, individit nuk përfundon doktoraturën, i anulohet liçenca e dhënë nga KKA.

9. Neni 17, pas pikës 8, të shtohet pika 9:

Ambiente të sigurta të mbrojtura 24orë apo të survejuara nga kamera sigurie, për depozitimin e gjetjeve të luajtshme arkeologjike.